



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 270/2 prot.,

Datë 10.02.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRAJLER” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-54604-12-21-2022, me objekt: “Rrethim dekorativ i stadiumit të lojrave me dorë”, me fond limit 3,335,385 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

**Ankimues:** “TRAJLER” SHPK  
*Adresa: “Bajram Curri”, Tropojë*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Tropojë  
*Adresa: Tropojë*

Në datën 09.02.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 270 prot., e operatorit ekonomik “TRAJLER” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-54604-12-21-2022, me objekt: “Rrethim dekorativ i stadiumit të lojrave me dorë”, me fond limit 3,335,385 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tropojë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TRAJLER” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:*

*b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “TRAJLER” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 270 prot., datë 09.02.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

**Arsyet e skualifikimit:**

*Formulari permbledhes i vetredeklarimit i paplote, konkretisht pjesa II "Shkaqet e perjashtimit' germa A "Deklarata per permbushjen e kriterëve te pergjithshme te kualifikimit', pikat ku citohet: operaatori ekonomik nuk eshte ne listen e operatoreve ekonomik te ndaluar per te fituar..." si dhe pika tjeter ku citohet se "Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij ne zbatim te kerkerkesave ligjore ne fuqi.." qe jane ne kundërshtim me Nenin 26 pika 3 e VKM-se nr.285 date 19.5.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publike".*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.02.2023.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**